

VENDIM
Nr. 2, datë 22.1.2014

PËR RINOVIM LICENCE SHA “UJËSJELLËS KANALIZIME FIER”

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/ “a” dhe nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, si dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë” Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Rinovim licence për efekt të përfundimit të afatit, operatorit sh.a. “Ujësjiellës-Kanalizime Fier”, me:
 - Drejtues ligjor: Salarjon Totaj
 - Drejtues teknik: Piro Ndreu.
2. Operatori sh.a. “Ujësjiellës-Kanalizime Fier” autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:
 - Kategoria A, për grubullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum;
 - Kategoria C, për largimin e ujërve të ndotura.
3. Zona e shërbimit të këtij operatori është bashkia Fier, Roskovec, komunat: Qendër, Topojë, Frakull, Dermenas, Levan, Kuman.
4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare, deri më 21.1.2018.

KRYETARI
Avni Dervishi